

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-111/14

**Prishtinë,
21 janar 2016**

Në çështjen juridike të:

E. V.

Pala ankuese/Në emër të paraqitësit të kërkesës

kundër.

Askush

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00854), të datës 27 Nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur me 21 janar 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e E. V. e paraqitur në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë M. V.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/220/2013 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA00854) i datës 27 Nëntor 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 30 Maj 2007 paraqitësi i kërkesës M. V. ka paraqitur kërkesë ku kërkon ri-posedimin pronën e paluajtëshme të evidentuar në gastrën kadastrale numër 334/1, zona kadastrale Kovragë/Kovrage me sipërfaqe prej 0 Hektarë, 20 Ari e 5 metra katrorë, me kulturë mal, duke pohuar se se ai ka humbur posedimin mbi pronën për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998/9, pa përmendur ndonjë datë konkrete si datë të humbjes.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij pala kishte dorëzuar dokumentet vijuese
 - Letërnjoftim datë 3 Janar 1987 lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendëshme në Mitrovicë (atëherë Mitrovica Titos) me adresë banimi në Anke Spajić, Mitrovicë;
 - Fletë poseduese nr. 155 datë 19 Gusht 1978 lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Istog;
 - Kopje e planit për ngastrën 334/1 lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Istog;
3. Më vonë bashkëshortja e paraqitësit të kërkesës E. V. (pala ankuese) ka paraqitur;
 - Certifikatën e vdekjes së paraqitësit të kërkesës datë 24 Qershor 2009 lëshuar nga autoritetet e regjistrimit civil paralel që dëshmon se paraqitësi i kërkesës M. V. kishte ndrruar jetë me 29 Maj 2009 dhe se E. V. ishte e bashkëshortja e ve e tij;
 - Fletën poseduese Nr.209 lëshuar nga kadastra e dislokuar që dëshmon se prona ishte e evidentuar në emër të paraqitësit të kërkesës M. V.;
 - Deklaratë me shkrim e dhënë nga pala ankuese E. V. në Agjencinë Kosovare të Pronave me 16 Shtator 2009 me të cilën ajo pohonte se nga e tërë pasuria e paluejtëshme e përshkruar në fletën posedues 209 në pronësi të të ndjerit, bashkëshortit të saj, përveç ngastrave 530/3, 530/4 dhe 530/5 të gjitha të tjerat janë shitur në vitin 1970 por nuk janë përkthyer në emër të pronarëve të rinj dhe kërkon që Komisioni me vendim të konfirmojë pronësinë me qëllim që të inicohet

procedura trashigimore përmes të cilës do të deklaroheshin pronarë ata të cilët e kanë blerë pronën nga ish bashkëshorti i saj.

- Aktvdekje e datës 24 Qershor 2009 lëshuar nga autoriteti i regjistrimit civil paralel në Mitrovicë ku në rubrikën e pasurisë së paluajtëshme të lënë pas të ndjerit M. V. numërohen vetëm banesa dhe garazha në Mitrovicë e jo edhe prona e kërkuar
4. Identifikimi fizik i pronës është bërë më 20 Shkurt 2008. Zyrtarët e Agjencisë kanë gjetur së prona është mal dhe në kohën kur është vizituar nuk ishte në përdorim të askujtë.
 5. Askush nuk ishte paraqitur për të kundërshtuar kërkesën apo për të marrë pjesë në procedurë
 6. Në raportin e konsoliduar të verifikimit të datës 6 Maj 2008 fleta poseduese nr. 209 ishte verifikuar pozitivisht me shenimet të dhënat kadastrale në Istog ishin verifikuar dhe krahasuar.
 7. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, nënfuqimin e pronës me Vendimin KPCC/D/A/19/2008, të datës 20 Qershor 2008, vendosi të aprovoi kërkesën e M. V. dhe të urdheroi se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se është pronar i tërë pasurisë së kërkuar dhe ka urdheruar që pala përgjegjëse, nëse ka, ta liroi pronën brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
 8. Ky vendim i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me datën 3 Prill 2009.
 9. Me datën 19 Shkurt 2010 me Resolutën numër KPCC/RES/15/2010 Komisioni konstatoi se një grup kërkeash të vendosura kishin mangësi në procesin e notifikimit dhe se nuk janë identifikuar fizikisht dhe notifikuar përkatësisht. Vendimi i Komisionit për këtë kërkesë u shfuqizua dhe kërkesa u kthyer Sekretarisë për riprocedim pasi të kryej edhe një herë notifikim fizik.
 10. Më 3 Gusht 2010, kërkesa ishte publikuar në Gazetën e Agjencisë, zyrën e UNHCR-së dhe ishte vendosur në hyrje të pronës së kërkuar. Përveç kësaj njoftimi ishte dërguar edhe në Komunën e Istogut, Gjykatën Komunale në Pejë dhe Zyrën Rajonale të Agjencisë. AKP-ja e ka konfirmuar njoftimin më datën 31 gusht 2010 dhe u konstatua se prona ishte identifikuar saktësisht
 11. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, nënfuqimin e pronës me Vendimin KPCC/D/A/147/2012, të datës 19 prill 2012 vendosi prapë të aprovoi kërkesën e M.V. dhe të urdheroi se paraqitësi i kërkesës ka

- dëshmuar se është pronar i tërë pasurisë së kërkuar dhe ka urdheruar që pala përgjegjëse, nese ka, ta liroi pronën brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
12. Bashkeshortja e paraqitësit të kërkesës, tani i ndjere, e ka pranuar vendimin e Komisionit me 26 shtator 2012.
 13. Me 21 gusht 2013 me rezolutën KPCC/RES/33/2013 Komisioni shfuqizon vendimin paraprak me kërkesën e Sekretariatit pasi që pala në rastin KPA00855 kishte deklaruar se bashkeshorti i saj tani i ndjerë e ka shitur pronën e kërkuar përfshirë edhe parcelën 334/1.
 14. Me shkresën e datës 9 tetor 2013 Sekretariati e kishte informuar paraqitësen e ankesës për shfuqizimin e Vendimit të mëparshëm.
 15. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), bazuar në provat e dorëzuara nga palët, njoftimin e pronës me Vendimin KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013 vendosi që kërkesa e M. V. të refuzohet.
 16. Komisioni në vendimin grupor dha arsyetimin specifik për kërkesën në fjalë në paragrafet 169 dhe 170 konstatoi se fillimisht paraqitësi i kërkesës kishte pohuar humbjën e pronës si rezultat i konfliktit por më vonë e kishte informuar Sekretarinë Ekzekutive të Agjencisë se prona ishte shitur më heret.
 17. Në kësi rrethanash Komisioni kishte konstatuar se humbja e pronës nuk ishte rezultat i rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur por se paraqitësi i kërkesës nuk kishte pasur të drejtë pronësore mbi pronën si rezultat i disponimit me vullnet të lirë me pronën në vitet 1970.
 18. Vendimin e atakuar pala e kishte pranuar me 26 mars 2014 dhe kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme me 22 prill 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

19. Pala ankuese, në ankesën e tij pretendon se nuk është bere vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, dhe se kushtet për marrjen e vendimit nga KKPK lidhur me pronën e kërkuar nuk janë përmbushur. Ajo tani pohon se prona e kërkuar në parcelën 334/1 nuk është shitur dhe se Komisioni nuk ka dhënë prova mbi të cilat ka ardh derite ky përfundim. Ajo pretendon se juridikisht është e pamundur që Komisioni të sjellë dy vendime një pas njëres në favor të saj kurs kete te fundit ta hudhe kërkesën.
20. Prandaj ajo i propozoi Gjykatës që të aprovoi ankesën dhe ta prish vendimin e Komisionit, të nxjerr Aktgjykim me të cilin i ktheht posedimi mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor**Pranueshmëria e ankesës:**

21. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni:

22. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave pronësore dhe kërkesave për të drejtat pronësore “që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.”
23. Gjykata Supreme ka juridiksion për të vendosur për ankesat ndaj vendimeve të Komisionit sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Meritat e ankesës:

24. Në vijim të shqyrtimit të shkresave të lëndës, të vendimit ankimor dhe pretendimeve në pajtim me nenin 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjeti se ankesa është pabazuar sepse Vendimi i ankimuar ishte marr jashtë fushëveprimit të KKPK-së dhe rrjedhimisht vendimi duhej pranuar dhe Kërkesa e M. V. duhet të hidhet si e palejuar për arsyet e cekura në vijim.
25. Gjatë procedurës para AKP-së pala ankuese e kishte pohuar në shkresën e datës 16 Shtator 2009 se qëllimi i kërimit të pronës ishte që të mundësohej procedura trashigimore pas të ndjerit paraqitësit të kërkesës dhe regjistrimi i pronës në emër të pronarëve të rinjë të cilët e kishin blerë pronën nga bashkëshorti i paraqitëses së ankesës në vitin 1970 dhe se përveç ngastrave 530/3, 530/4 dhe 530/5 të gjitha të tjerat janë shitur në vitin 1970 por nuk janë përkthyer në emër të pronarëve të rinjë.
26. Në Aktvdekjen e datës 24 Qershor 2009 që paraqet dokumentin e inicimit të procedurës trashigimpre përpara gjykatës kompetente, të lëshuar nga autoriteti i regjistrimit civil paralel në Mitrovicë vihet re në rubrikën e pasurisë së paluajtshme- masës trashigimore, të lënë

pas të ndjerit M. V. numërohen vetëm banesa dhe garazha në Mitrovicë e jo edhe prona e kërkuar

27. Nga verifikimet e kryera nga ekipi verifikues i AKP-së, në raportin e konsoliduar të verifikimit të datës 6 Maj 2008 rezulton se lista poseduese nr. 209 është gjetur në Departamentin e kadastrit në Istog dhe prona është evidentuar në emër të paraqitësit të kërkesës.
28. Gjykata Supreme vëren se KKKPK-ja ka marrë vendim jashtë fushëveprimit të paraparë me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
29. KKKPK-ja ka kompetencë të pranoi kërkesat si në pikën 21 të këtij aktgjykimi dhe qartazi shihet se humbja e së drejtës pronësore nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë apo rezultonë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999 por si heqje dore e villnetëshme nga prona përmes shitjes vite më parë.
30. Lidhur me pretendimin e palës ankuese se është e paligjëshme që Komisioni të sjellë dy vendime me përfundim kundërthënës Gjykata mori në shqyrtim pretendimet ankimore por gjeti se Komisioni në Rezolutën e parë kishte anuluar vendimin e vet për veprime joadekuate procedurale kurse në resolutën e dytë poashtu kishte anuluar vendimin e vet për shkak se me deklarin e vetë se prona është shitur në vitet 70-ta , kjo e zhvendoste kërkesën jashtë afateve dhe fushëveprimit të Komisionit. Gjykata gjeti se vendimi duhej prishur dhe se kërkesa e M. V. duhej hudhe për mungesë të juridiksionit nga ana e KKKPK-së.
31. Nga arsyet e paraqitura me sipër dhe ne përputhje me nenin 13.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gutaityte, Referent i EULEX-it